



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. _____ Kaçanik, 17.03.2010

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale 03/L-040, dhe duke u bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet MPMS i themeluar me Vendimin 5/166 të zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës, Kryetari i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur më 17.03.2010 nxjerr këtë:

V E N D I M

për formimin e komitetit lokal të veprimit mbi monitorimin e punës së fëmijëve

1

Formohet Komiteti Lokal i Veprimit mbi monitorimin e punës së fëmijëve në Komunën e Kaçanikut, në përbërje prej 16 anëtarëve, nga Zyrtar të lartë të autoriteteve lokale, Përfaqësuesit e institucioneve qendrore, Përfaqësuesve të partnerëve social dhe të Shoqërisë civile.

2

Udhëheqës i Komitetit Lokal të Veprimit për MPF është Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i komunës Kaçanikut i cili do të caktoj një koordinator të KLV që do të ketë rolin e sekretarit.

3

Komitetit Lokal i Veprimit, punën dhe aktivitetin do ta zhvilloj sipas Udhëzimit administrativ Nr. 17/2008 për Parandalimin dhe eliminimin e punëve të rrezikshme për fëmijët në komunën e Kaçanikut.

4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

5

Me këtë vendim të njoftohen: MPMS, Instituti për politikë sociale, Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, anëtarët e Komitetit lokal të veprimit.

Komunës

Kryetari i

z. Xhabir Zharku